



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA “ALBPETROL” SHA

Patos më, 10.10.2025

SHTOJCË

Në Dokumentat Standarte të Tenderit me objekt:
"Ndërtim gropa avarie (rezervuarë b.a.), në sheshet e puseve, në Sektorin Cakran-Mollaj" me
REF-63300-10-01-2025

Autoriteti Kontraktor Albpetrol sha (Njësia e Prokurimit) bazuar në ligjin nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 75 “Sqarimet dhe ndryshimi në dokumentat e tenderit”, pas komunikimit dhe sygjërimeve të APP-së, vendosi të hartojë këtë shtojcë me përmbajtje si më poshtë:

1. Në Shtojcën 7 “Formular I Kritereve Të Përzgjedhjes/Kualifikimit”, pika 2.2 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” pika 2.2.1., të DST-së, bëhen ndryshimet si më poshtë:

Ishte:

- 2.2.1. Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

Bëhet:

- 2.2.1 Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit limit.
2. Në Shtojcën 7 “Formular I Kritereve Të Përzgjedhjes/Kualifikimit”, pika 2.3 “Kapaciteti teknik” pika 2.3.1., të DST-së, bëhen ndryshimet si më poshtë:

Ishte:

- 2.3.1 Operatorët ekonomikë duhet të kenë përvojë të suksesshme në kontrata të mëparshme dhe për këtë duhet të paraqesin :
 - a) dokumentacion për punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të ulët se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
 - b) dokumentacion për punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e ulët se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do

të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

Për kontrata të realizuara me ente publike operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Aktin e kolaudit;

Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm :

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve, (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Fatura tatimore përkatëse, të deklaruara në organet tatimore

Bëhet:

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të kenë përvojë të suksesshme në kontrata të mëparshme dhe për këtë duhet të paraqesin :

- a) dokumentacion për punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- b) dokumentacion për punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Në rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

Për kontrata të realizuara me ente publike operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Aktin e kolaudit;

Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm :

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve, (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Fatura tatimore përkatëse, te deklaruara ne organet tatimore

Njësia e Prokurimit: